



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK & MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr 2232/prot.

Tepelenë, më 03.08 2026

Lënda: Përcjellje e materialeve për shqyrtim dhe kërkesë për thirrjen e mbledhjes jashtë radhe të Këshillit Bashkiak.

Drejtuar:

KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2026 dhe Udhëzimit Plotësues nr. 19, datë 10.07.2026 të Ministrit të Financave, ju përcjellim për shqyrtim dhe miratim **Projekt-Dokumentin e Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029** dhe dokumentacionin shoqërues.

Projekt-Dokumenti i Parë i PBA 2027–2029 është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe kalendarin e procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm. Gjithashtu, janë zhvilluar konsultimet publike dhe janë reflektuar vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura gjatë këtij procesi.

Duke marrë në konsideratë afatet e përcaktuara për vijimin e procedurave të Programit Buxhetor Afatmesëm, si dhe detyrimin për pasqyrimin e të dhënave në sistemet **SIFQ** dhe **SMBV**, kërkojmë që materiali të përfshihet në rendin e ditës dhe të shqyrtohet në një **mbledhje jashtë radhe të Këshillit Bashkiak**, e cila të zhvillohet në afatin më të shkurtër të mundshëm, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe Rregullorja e Këshillit Bashkiak.

Bashkëlidhur kësaj shkrese dërgohen:

1. Projektvendimi "Për miratimin e Projekt-Dokumentit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029";
2. Relacioni shoqërues;
3. Projekt-Dokumenti i Parë i PBA 2027–2029;
4. Aneksi nr. 1 – Numri maksimal i punonjësve;
5. Aneksi nr. 2 – Parashikimet afatmesme të të ardhurave;
6. Aneksi nr. 3 – Tavanet përgatitore të shpenzimeve sipas programeve buxhetore;
7. Aneksi nr. 4 – Shpenzimet sipas natyrës ekonomike;
8. Aneksi nr. 5 – Shpenzimet kapitale dhe lista e investimeve për periudhën 2027–2029.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të shqyrtimit të materialeve brenda afateve të përcaktuara.

**PËR KRYETARIN E BASHKISË
NËNKRYETARI I BASHKISË**

(Në zbatim të Urdhrit të Delegimit të Funksioneve Nr. 94, datë 31.07 2026)

Spiro KORA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr 2384 prot

BASHKIA TEPELENË

Tepelenë, më 31. 07. 2026

URDHËR

Nr 84 Date 31. 07. 2026

"PËR DELEGIM KOMPETENCE"

Mbështetur në: nenin 64 /f të Ligjit 139 /2015 "Per Vetqeverisjen Vendore"; Ligjit nr 44/2015 "Kodi i procedurave Administrative" i ndryshuar; si dhe nenit 11, pikat 2 dhe 3 të ligjit 90/2012 "për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" nenin 7/1 të Rregullores së Brendëshme të Bashkisë Tepelenë, me qëllim të mirëfunksioneve të Bashkisë Tepelenë

URDHËROJ

1. Të delegoj kompetencën e nënshkrimit të shkresave të përditëshme: koorespondencë me institucionet, kthim përgjigje qytetarëve, vërtetime për qytetarët nënkryetarit të Bashkisë z. Spiro Kora.
2. Kompetencat do të ushtrohen për periudhën nga data 03.08.2026 deri më datën 10.08.2026.
3. Me zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet nënkryetari i Bashkisë Tepelenë z. Spiro Kora.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Gramos Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENE

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK & MENAXHIMIT FINANCIAR

RELACION

Mbi Projektvendimin “Për miratimin e Dokumentit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029”

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 41 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2025 të Ministrit të Financave “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor”, të shkresës së Ministrisë së Financave nr.10436, datë 16.06.2026, si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.21, datë 30.03.2026 “Për miratimin e parashikimeve të të ardhurave dhe tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029”, paraqitet për shqyrtim dhe miratim Dokumenti i Parë i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 i Bashkisë Tepelenë.

Programi Buxhetor Afatmesëm është instrumenti kryesor i planifikimit strategjik dhe financiar të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Nëpërmjet tij përcaktohen objektivat e zhvillimit, prioritetet sektoriale, burimet financiare dhe shpërndarja e tyre në funksion të ofrimit të shërbimeve publike dhe realizimit të investimeve prioritare gjatë periudhës trevjeçare.

I. Qëllimi i relacionit

Ky relacion hartohet me qëllim informimin e Këshillit të Bashkisë Tepelenë mbi përmbajtjen e Dokumentit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, argumentimin e parashikimeve financiare dhe paraqitjen e prioriteteve të zhvillimit të bashkisë për periudhën afatmesme.

Dokumenti synon:

- të sigurojë një planifikim financiar realist dhe të qëndrueshëm;
- të garantojë përdorimin me eficiencë, efektivitet dhe transparencë të fondeve publike;
- të orientojë burimet financiare drejt prioriteteve strategjike të zhvillimit vendor;
- të krijojë bazën për hartimin e buxheteve vjetore të viteve 2027, 2028 dhe 2029;
- të harmonizojë prioritetet e Bashkisë Tepelenë me politikat kombëtare të zhvillimit dhe programet e financimit.

II. Përmbajtja e Dokumentit të Parë të PBA 2027–2029

Dokumenti i Parë i Programit Buxhetor Afatmesëm përfshin:

- analizën e të ardhurave të programuara dhe burimeve të financimit;
- planifikimin e shpenzimeve sipas programeve buxhetore;
- planifikimin e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike;
- planifikimin e investimeve kapitale për periudhën 2027–2029;
- numrin maksimal të punonjësve dhe ndikimin e tij në buxhet;
- analizën e risqeve fiskale dhe masat për administrimin e tyre;
- projektet me financim dhe bashkëfinancim nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare;
- rekomandimet e Ministrisë së Financave mbi përmirësimin e planifikimit buxhetor.

III. Procesi i hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm

Hartimi i Dokumentit të Parë të PBA 2027–2029 është realizuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe metodologjinë e përcaktuar nga Ministria e Financave.

Procesi ka përfshirë:

- analizën e realizimit të buxhetit të viteve të mëparshme;
- vlerësimin e të ardhurave të veta dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit;
- përcaktimin e tavaneve buxhetore për çdo program;
- konsultimin me të gjitha drejtoritë dhe njësitë shpenzuese të Bashkisë;
- identifikimin dhe priorizimin e investimeve kapitale;
- harmonizimin e planifikimit financiar me Strategjinë e Zhvillimit Vendor dhe dokumentet sektoriale.

Gjatë hartimit të dokumentit janë marrë në konsideratë nevojat e komunitetit, objektivat e zhvillimit ekonomik e social të Bashkisë Tepelenë, si dhe kufizimet financiare që lidhen me burimet e disponueshme për periudhën afatmesme.

Dokumenti është ndërtuar mbi parimet e disiplinës fiskale, transparencës, qëndrueshmërisë financiare, përgjegjshmërisë në administrimin e fondeve publike dhe orientimit të shpenzimeve drejt rezultateve konkrete në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

IV. Procesi i Konsultimit Publik dhe Dëgjesat me Komunitetin

Një nga parimet themelore të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm është transparenca dhe përfshirja e qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor. Në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor, Bashkia Tepelenë organizoi procesin e konsultimit publik për Dokumentin e Parë të PBA 2027–2029.

Procesi i konsultimit u zhvillua në bashkëpunim me administratorët e njësive administrative, drejtoritë e bashkisë, institucionet vendore, organizatat e interesit dhe komunitetin, me synim evidentimin e nevojave prioritare dhe përfshirjen e tyre në planifikimin afatmesëm të buxhetit.

Në kuadër të këtij procesi u zhvilluan dëgjesa publike në të katër njësitë administrative të Bashkisë Tepelenë sipas këtij kalendari:

Data	Njësia Administrative
28.07.2026	Kurvelesh
30.07.2026	Qytet
30.07.2026	Qender
31.07.2026	Lopës

Gjatë këtyre dëgjesave u prezantuan:

- parashikimet e të ardhurave për periudhën 2027–2029;
- tavanet buxhetore sipas programeve;
- prioritetet e investimeve kapitale;
- projektet që do të financohen nga të ardhurat e veta dhe transfertat e buxhetit të shtetit;
- projektet me bashkëfinancim dhe projektet që synojnë tërheqjen e fondeve nga donatorët dhe programet e Bashkimit Evropian.

Në takime morën pjesë qytetarë, përfaqësues të këshillave të fshatrave, administratorë të njësive administrative, përfaqësues të institucioneve publike, subjekte të biznesit dhe organizata të shoqërisë civile.

Nga diskutimet u evidentuan si prioritet kryesor:

- përmirësimi i infrastrukturës rrugore;
- investimet në institucionet arsimore;
- rehabilitimi i sistemeve ujitëse dhe kulluese;
- mbështetja e bujqësisë dhe zhvillimit rural;
- rritja e investimeve në shërbimet publike vendore;
- mbështetja e turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore.

Sugjerimet e paraqitura gjatë procesit të konsultimit publik janë shqyrtuar nga grupi i punës për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe janë reflektuar në masën që kanë qenë të realizueshme financiarisht dhe në përputhje me prioritetet strategjike të Bashkisë Tepelenë.

Ky proces ka kontribuar në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe besimit të komunitetit ndaj procesit të planifikimit buxhetor, duke garantuar që investimet dhe shërbimet e programuara të reflektojnë sa më mirë nevojat e qytetarëve.

V. Analiza e Burimeve Njerëzore

Programi Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 parashikon ruajtjen e strukturës aktuale organizative të Bashkisë Tepelenë, duke garantuar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve publike pa rritur numrin e punonjësve.

Sipas Dokumentit të Parë të PBA-së, numri maksimal i punonjësve është planifikuar si më poshtë:

Përshkrimi	2027	2028	2029
Punonjës të përhershëm	240	240	240
Punonjës me kontratë	15	15	15

Ruajtja e të njëjtit numër punonjësish gjatë gjithë periudhës së planifikimit reflekton politikën e Bashkisë për administrim të kujdesshëm të fondeve publike dhe kontroll të shpenzimeve të personelit.

Objektivi kryesor nuk është zgjerimi i administratës, por rritja e eficiencës së saj nëpërmjet:

- zhvillimit të kapaciteteve profesionale të punonjësve;
- përdorimit më efikas të teknologjisë dhe shërbimeve digjitale;
- përmirësimit të monitorimit të performancës;
- rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Në të njëjtën kohë, Bashkia do të vijojë të analizojë çdo vit nevojat për burime njerëzore në funksion të ndryshimeve ligjore, zgjerimit të shërbimeve dhe prioriteteve të zhvillimit vendor.

VI. Analiza e të Ardhurave për Periudhën 2027–2029

Parashikimi i të ardhurave është mbështetur në analizën e realizimit të viteve të mëparshme, ecurinë e mbledhjes së të ardhurave vendore, transfertat nga Buxheti i Shtetit dhe parashikimet e Ministrisë së Financave.

Struktura e burimeve financiare paraqitet si më poshtë:

- të ardhurat e trashëguara;
- të ardhurat e veta;
- transfertat e pakushtëzuar;
- transfertat sektoriale.

Analiza e treguesve financiarë tregon se buxheti i Bashkisë Tepelenë paraqet një tendencë rritëse gjatë gjithë periudhës së Programit Buxhetor Afatmesëm.

Totali i buxhetit rritet nga **385.636 mijë lekë** në vitin 2027 në **406.321 mijë lekë** në vitin 2029, duke reflektuar një rritje të qëndrueshme të burimeve financiare në dispozicion të bashkisë.

Rritja mbështetet kryesisht në:

- rritjen progresive të transfertës së pakushtëzuar;
- rritjen graduale të të ardhurave të veta;
- ruajtjen e transfertave sektoriale në nivele të qëndrueshme.

Megjithëse të ardhurat e veta shfaqin tendencë pozitive, ato vazhdojnë të zënë një peshë relativisht të ulët në totalin e buxhetit. Për këtë arsye, gjatë periudhës 2027–2029 do të vijojë puna për:

- forcimin e administrimit fiskal vendor;

- përmirësimin e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore;
- zgjerimin e bazës së tatueshme;
- rritjen e eficiencës së administrimit të aseteve publike;
- identifikimin e burimeve të reja të financimit.

Analiza e të ardhurave tregon se Bashkia Tepelenë ruan një ekuilibër të qëndrueshëm financiar, duke garantuar mbulimin e shpenzimeve operative, financimin e investimeve kapitale dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore gjatë gjithë periudhës së Programit Buxhetor Afatmesëm.

VII ANALIZA E SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE, NATYRËS EKONOMIKE DHE INVESTIMEVE KAPITALE

1. Analiza e shpenzimeve sipas programeve buxhetore

Në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, Bashkia Tepelenë ka planifikuar shpenzimet publike mbi bazën e prioriteteve strategjike të zhvillimit të territorit, nevojave të komunitetit dhe objektivave të përcaktuara në politikat vendore.

Totali i shpenzimeve të planifikuara për periudhën afatmesme paraqitet si më poshtë:

Viti Totali i shpenzimeve (000 lekë) Ndryshimi % ndryshim

2027 385,636	-	-
2028 394,753	+9,117	+2.3 %
2029 406,321	+11,568	+2.9 %

Nga analiza rezulton se buxheti i Bashkisë Tepelenë paraqitet i balancuar për të tre vitet e periudhës afatmesme, ku rritja progresive e shpenzimeve lidhet kryesisht me rritjen e kostove të shërbimeve publike, nevojat për mirëmbajtje të infrastrukturës dhe rritjen graduale të fondeve të destinuara për investime.

Programet me peshën më të madhe në strukturën e shpenzimeve janë:

- **Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” (O1110)**, i cili përbën programin me peshën më të lartë në buxhet, me rreth 29% të totalit në vitin 2027 dhe rritje në 31.6% në vitin 2029. Ky program garanton funksionimin institucional, administrimin financiar dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.
- **Programi “Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor” (O9120)**, me rreth 19% të buxhetit në vitet 2027-2028 dhe 17% në vitin 2029, duke reflektuar prioritetin e bashkisë për garantimin e kushteve sa më të mira në institucionet arsimore.

- Programi “Shërbime publike vendore” (O6260) dhe “Menaxhimi i mbetjeve” (O5100) zënë përkatësisht rreth 10% dhe 9% të buxhetit total, duke garantuar ofrimin e shërbimeve bazë ndaj qytetarëve.
- Programet për rrjetin rrugor rural, mbrojtjen civile, administrimin e pyjeve dhe kullotave, kulturën dhe ujitjen/kullimin mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe përmirësimin e shërbimeve në njësitë administrative.

2. Analiza e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike

Struktura ekonomike e shpenzimeve për periudhën 2027-2029 paraqet një ndarje të fondeve ndërmjet shpenzimeve të personelit, shpenzimeve operative, transfertave dhe investimeve kapitale.

Nga analiza rezulton se:

- **Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)** mbeten zëri kryesor i buxhetit, duke zënë rreth 54% të totalit në vitin 2027 dhe rreth 53% në vitin 2029. Kjo lidhet me karakterin e shërbimeve vendore, të cilat kërkojnë kapacitete njerëzore për administrimin dhe ofrimin e shërbimeve publike.
- **Sigurimet shoqërore (601)** zënë rreth 8-9% të buxhetit total.
- **Shpenzimet operative (602)** përbëjnë rreth 16-18% të buxhetit dhe mbulojnë nevojat për funksionimin e institucioneve, mirëmbajtjen dhe ofrimin e shërbimeve.
- **Shpenzimet kapitale (230 dhe 231)** paraqesin rritje nga viti në vit, duke kaluar nga rreth 44.2 milion lekë në vitin 2027 në rreth 51 milion lekë në vitin 2029, duke reflektuar orientimin gradual të bashkisë drejt investimeve zhvillimore.

Kjo strukturë tregon një administrim të qëndrueshëm financiar, por njëkohësisht evidenton nevojën për rritjen e mëtejshme të peshës së investimeve kapitale ndaj shpenzimeve totale.

3. Analiza e investimeve kapitale

Programi i investimeve kapitale për periudhën 2027-2029 është hartuar duke u mbështetur në prioritetet e zhvillimit të Bashkisë Tepelenë dhe në nevojat për përmirësimin e infrastrukturës publike, arsimit, banesave dhe mbrojtjes së burimeve ujore.

Investimet kapitale të planifikuara paraqiten si më poshtë:

Viti Investime kapitale (000 lekë)

2027 16,938

Viti Investime kapitale (000 lekë)

2028 28,468

2029 23,428

Projektet kryesore prioritare janë:

1. Bashkëfinancim për rikonstrukcionin e Shkollës “7 Marsi”

Programi: Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor (O9120)

Ky projekt synon përmirësimin e kushteve infrastrukturore të institucionit arsimor dhe rritjen e cilësisë së mjediseve të mësimin.

Financimi i planifikuar:

- Viti 2027: **6,972 mijë lekë**
- Viti 2028: **11,658 mijë lekë**
- Viti 2029: **4,362 mijë lekë**

Ky investim realizohet në formën e bashkëfinancimit me kontribut vendor prej **15%**, duke siguruar pjesëmarrjen e bashkisë në një projekt me rëndësi të veçantë për arsimin.

2. Përmirësimi i banesave ekzistuese

Ky projekt synon përmirësimin e kushteve të banimit për familjet përfituese dhe rritjen e standardeve të jetesës.

Financimi i planifikuar:

- Viti 2027: **2,305 mijë lekë**
- Viti 2028: **7,310 mijë lekë**
- Viti 2029: **15,335 mijë lekë**

Projekti parashikohet të realizohet me **bashkëfinancim në masën 40%**, duke mobilizuar burime financiare shtesë për ndërhyrje në banesat ekzistuese.

3. Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit të Turanit

Ky investim lidhet me përmirësimin e sigurisë së veprave ujore dhe mbështetjen e menaxhimit të burimeve ujore në territor.

Financimi i planifikuar:

- Viti 2027: **5,621 mijë lekë**
- Viti 2028: **9,500 mijë lekë**
- Viti 2029: **3,731 mijë lekë**

Projekti realizohet me **bashkëfinancim në masën 20%**.

4. Projekti ARIADNE – Programi INTERREG VI-A IPA Greqi–Shqipëri

Ky projekt mbështet zhvillimin kulturor dhe promovimin e trashëgimisë lokale në kuadër të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar.

Financimi i planifikuar:

- Viti 2027: **2,040 mijë lekë**
- Viti 2028: 0 lekë
- Viti 2029: 0 lekë

4. Analiza e projekteve me bashkëfinancim

Bashkia Tepelenë gjatë periudhës 2027-2029 do të vijojë përdorimin e mekanizmit të bashkëfinancimit si një instrument për rritjen e kapaciteteve investuese dhe realizimin e projekteve me ndikim të drejtpërdrejtë për komunitetin.

Projektet kryesore me bashkëfinancim janë:

- Rikonstrukcioni i Shkollës “7 Marsi” – bashkëfinancim 15%;
- Përmirësimi i banesave ekzistuese – bashkëfinancim 40%;
- Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Turan – bashkëfinancim 20%.

Këto investime synojnë përmirësimin e infrastrukturës arsimore, sociale dhe të sigurisë së territorit.

VIII VLERËSIMET DHE REKOMANDIMET E MINISTRISË SË FINANCAVE PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029

Në kuadër të procesit të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, Bashkia Tepelenë ka përgatitur dhe paraqitur dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe metodologjik për menaxhimin e financave publike vendore.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se Bashkia Tepelenë ka reflektuar kërkesat kryesore të procesit të planifikimit buxhetor afatmesëm, duke hartuar për secilin program

buxhetor deklaratat e politikave të programit, objektivat, produktet dhe treguesit përkatës të performancës.

Në veçanti, është vlerësuar:

- **Plotësimi i dokumenteve të politikave të programeve buxhetore (PBA 6)**, ku janë evidentuar qëllimet, objektivat dhe rezultatet e pritshme për secilin program funksional të bashkisë. Këto dokumente krijojnë një lidhje më të qartë ndërmjet prioritetëve të zhvillimit vendor dhe fondeve të planifikuara.
- **Hartimi i shpenzimeve sipas produkteve të programeve (PBA 7)**, ku fondet e parashikuara janë lidhur me produktet konkrete që synohet të realizohen gjatë periudhës 2027-2029.
- **Përputhshmëria ndërmjet objektivave të programeve dhe burimeve financiare të planifikuara**, duke garantuar që përdorimi i fondeve publike të orientohet drejt realizimit të shërbimeve me ndikim të drejtpërdrejtë për qytetarët.

Ministria e Financave vlerëson se programet prioritare të Bashkisë Tepelenë lidhen kryesisht me:

- përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve publike vendore;
- përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe mbështetjen e arsimit bazë dhe parashkollor;
- përmirësimin e aksesit në zonat rurale përmes ndërhyrjeve në rrjetin rrugor;
- zhvillimin e potencialeve turistike dhe promovimin e trashëgimisë kulturore;
- forcimin e kapaciteteve për mbrojtjen civile dhe menaxhimin e situatave emergjente.

Gjithashtu, është evidentuar se Bashkia Tepelenë ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të territorit, duke pasur parasysh potencialin turistik të zonës, burimet natyrore dhe mundësitë për zhvillimin e sektorëve të bujqësisë dhe shërbimeve.

Rekomandimet e Ministrisë së Financave

Për përmirësimin e mëtejshëm të procesit të planifikimit dhe menaxhimit financiar, Ministria e Financave rekomandon:

1. Përmirësimin e analizës së të ardhurave vendore

Bashkia duhet të vijojë punën për rritjen e nivelit të realizimit të të ardhurave të veta, duke analizuar në mënyrë periodike burimet ekzistuese të të ardhurave, nivelin e arkëtimit dhe problematikat që ndikojnë në realizimin e tyre.

Kërkohet që planifikimi i të ardhurave të mbështetet në analiza më të detajuara historike, duke evidentuar masat konkrete për rritjen e performancës së administrimit fiskal.

2. Menaxhimi i detyrimeve të prapambetura

Një prioritet i rëndësishëm mbetet monitorimi dhe administrimi i stokut të detyrimeve të prapambetura.

Bashkia duhet të vijojë:

- evidentimin periodik të detyrimeve ekzistuese;
- planifikimin e fondeve për shlyerjen e tyre;
- marrjen e masave për të shmangur krijimin e detyrimeve të reja.

3. Rritja e peshës së investimeve kapitale

Duke vlerësuar rëndësinë e investimeve për zhvillimin e territorit, rekomandohet orientimi gradual i një pjese më të madhe të burimeve financiare drejt projekteve kapitale që kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek komuniteti.

Në këtë drejtim, prioritet duhet t'u jepet:

- infrastrukturës rrugore;
- objekteve arsimore;
- ujitjes dhe kullimit;
- përmirësimit të shërbimeve publike.

4. Përmirësimi i monitorimit të performancës së programeve

Bashkia duhet të vijojë monitorimin e realizimit të objektivave dhe produkteve të përcaktuara në dokumentet e PBA-së, duke analizuar jo vetëm realizimin financiar, por edhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara.

5. Forcimi i transparencës dhe pjesëmarrjes së komunitetit

Procesi i planifikimit buxhetor duhet të vijojë të shoqërohet me konsultime publike dhe informim të qytetarëve, duke siguruar që prioritetet e komunitetit të reflektohen në programet dhe investimet e bashkisë.

VI. PËRFUNDIME DHE PROPOZIM PËR MIRATIM

Dokumenti I parë i Programi Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 i Bashkisë Tepelenë është hartuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor për menaxhimin e financave publike dhe udhëzimet për hartimin e buxhetit afatmesëm vendor.

Analiza e strukturës së shpenzimeve tregon se Bashkia Tepelenë ka ndërtuar një planifikim financiar të balancuar, ku sigurohet vazhdimësia e ofrimit të shërbimeve publike dhe njëkohësisht krijohen mundësi për realizimin e investimeve prioritare.

Gjatë periudhës 2027-2029, prioritetet kryesore financiare të bashkisë janë:

- garantimi i funksionimit normal të administratës dhe shërbimeve publike;
- mbështetja e arsimit dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore;

- përmirësimi i rrjetit rrugor dhe aksesit në zonat rurale;
- investimet në mbrojtjen civile dhe sigurinë e territorit;
- rehabilitimi dhe përmirësimi i infrastrukturës ujore;
- mbështetja e zhvillimit ekonomik dhe turistik të territorit;
- rritja e eficiencës në përdorimin e fondeve publike.

Investimet kapitale të planifikuara, përfshirë projektet me bashkëfinancim si rikonstrukcioni i Shkollës “7 Marsi”, përmirësimi i banesave ekzistuese, rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Turan dhe projekti ARIADNE, përbëjnë ndërhyrje me ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit.

Në përfundim, vlerësohet se Programi Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 përfaqëson një instrument të rëndësishëm për orientimin e politikave vendore, menaxhimin e qëndrueshëm financiar dhe realizimin e objektivave të zhvillimit të Bashkisë Tepelenë.

Për sa më sipër, i propozohet **Këshillit të Bashkisë Tepelenë**:

Të miratojë Dokumentin e Pare të Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Tepelenë, së bashku me tabelat financiare, relacionin shpjegues dhe anekset përkatëse, si pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Drejtore

Spiro Kora



KRYETARI I BASHKISË

Gramos Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË

KESHILLI BASHKIAK

Nr. 2232 prot.

Date _____ 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2026

PËR

MIRATIMIN E PROJEKT-DOKUMENTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM (PBA) 2027–2029 TË BASHKISË TEPELENË

Këshilli i Bashkisë Tepelenë, në mbledhjen e dates _____ 2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë “Për miratimin e Projekt-Dokumentit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 të Bashkisë Tepelenë”,

Në mbështetje të:

- nenit 41 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar;
- ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar;
- ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027–2029”;
- Udhëzimit Plotësues nr. 19, datë 10.07.2026;
- shkresës së Ministrisë së Financave nr. 10436, datë 16.06.2026;

V E N D O S I:

1. Të miratojë **Projekt-Dokumentin e Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 të Bashkisë Tepelenë**, së bashku me materialet shoqëruese dhe anekset bashkëlidhur këtij vendimi, të cilat janë pjesë përbërëse e tij.
2. Të miratohen si pjesë përbërëse e këtij vendimi anekset e mëposhtme:
 - **Aneksi Nr. 1** – Numri maksimal i punonjësve për periudhën 2027–2029;
 - **Aneksi Nr. 2** – Parashikimet afatmesme të të ardhurave 2027–2029;
 - **Aneksi Nr. 3** – Shpenzimeve sipas programeve buxhetore;
 - **Aneksi Nr. 4** – Shpenzimet sipas natyrës ekonomike;

- **Aneksi Nr. 5** – Shpenzimet kapitale dhe lista e prioriteteve të investimeve 2027–2029.

3. “Miratimin e Aneksit nr. 5/1 ‘Bashkëfinancimet e planifikuara për periudhën afatmesme 2027-2029’, si pjesë shoqëruese e dokumentacionit të Programit Buxhetor Afatmesëm.” dhe do të realizohet në përputhje me:

- marrëveshjet përkatëse të financimit dhe bashkëfinancimit;
- planifikimin shumëvjeçar të investimeve;
- fondet e miratuara në buxhetin vjetor të Bashkisë Tepelenë;
- kërkesat dhe procedurat e zbatueshme të menaxhimit financiar publik.

Projektet e bashkëfinancimit do të pasqyrohen në sistemet financiare përkatëse **SIFQ dhe SMBV**, sipas strukturës buxhetore dhe fazave të zbatimit të tyre.

4. Ngarkohet **Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar**, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë Tepelenë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE LIGJORE & ORGANIZATIVE
Julinda KARTERI

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK & MENAXHIMIT FINANCIAR
Spiro KORA

KRYETARI I KËSHILLIT
Arben GUMENI

ANEKSI NR. 1

NUMRI MAKSIMAL I PUNONJËSVE

PËR PERIUDHËN AFATMESME 2027-2029

Në zbatim të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027-2029 të Bashkisë Tepelenë, miratohet numri maksimal i punonjësve për periudhën afatmesme, sipas strukturës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	2027	2028	2029
1	Numri i punonjësve	240	240	240
2	Numri i punonjësve me kontratë	15	15	15
	TOTALI	255	255	255

Numri maksimal i punonjësve i planifikuar për periudhën 2027-2029 do të zbatohet në përputhje me strukturën organizative të miratuar të Bashkisë Tepelenë, nevojat për ofrimin e shërbimeve publike vendore dhe kufijtë financiarë të përcaktuar në Programin Buxhetor Afatmesëm.

KRYETARI I KËSHILLIT

Arben GUMENI

ANEKSI NR. 2

PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PËR PERIUDHËN 2027–2029

Në zbatim të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 të Bashkisë Tepelenë, paraqiten parashikimet afatmesme të të ardhurave sipas burimeve të financimit, si më poshtë:

(000/lekë)

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	2027	2028	2029
1	Të ardhura të trashëguara	2,000	2,000	2,000
2	Të ardhurat e veta	67,000	68,000	70,000
3	Transferta e pakushtëzuar	177,132	185,289	193,452
4	Transferta sektoriale	140,017	140,017	141,417
TOTALI I BUXHETIT		386,149	395,306	406,869

Parashikimet e të ardhurave për periudhën 2027–2029 janë hartuar mbi bazën e pritshmërive për realizimin e të ardhurave të veta vendore, transfertave nga Buxheti i Shtetit, si dhe burimeve të tjera të financimit të parashikuara në kuadrin e Programit Buxhetor Afatmesëm.

KRYETARI I KËSHILLIT

Arben GUMENI

ANEKSI NR. 3

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN 2027-2029

Në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027-2029 të Bashkisë Tepelenë,
miratohen tavanet përgatitore të shpenzimeve sipas programeve buxhetore, si më poshtë:
(000/lekë)

Nr.	Emërtimi i Programit	Kodi i Programit Buxhetor	2027	2028	2029
1	Planifikimi , Menaxhim i dhe Administrimi	O1110	111,606	116,304	135,236
2	Fond Rezervë	O4910	5,500	5,000	5,500
3	Fond Kontigjenc e	O4940	5,500	5,000	5,500
4	Kujdesi social për fëmijët (Çerdhe)	O10140	8,068	8,270	8,525
5	Shërbime publike vendore	O6260	38,923	39,906	41,384
6	Menaxhim i imbetjeve	O5100	33,822	36,042	36,888
7	Trashëgimia kulturore, eventet artistike	O8220	12,055	12,356	12,850

Nr.	Emërtimi i Programit	Kodi i Programit Buxhetor	2027	2028	2029
8	dhe kulturore Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	O9120	81,744	86,430	73,284
9	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	O9230	13,546	13,546	13,682
10	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	O4260	17,315	17,344	18,274
11	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	O4240	4,871	4,871	4,908
12	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	O3280	22,685	22,685	22,912
13	Rrjeti rrugor rural	O4520	15,514	12,252	12,426
14	Mbrojtja civile	O3280	15,000	15,300	15,500
	Totali		386,149	395,306	406,869

Shpenzimet sipas programeve buxhetore për periudhën 2027–2029 përfaqësojnë kufijtë financiarë orientues për hartimin e buxheteve vjetore dhe realizimin e objektivave të programeve të Bashkisë Tepelenë.

Këto tavane do të detajohen më tej sipas natyrës ekonomike të shpenzimeve, produkteve dhe aktiviteteve të përcaktuara në dokumentin e plotë të Programit Buxhetor Afatmesëm.

KRYETARI I KËSHILLIT

Arben GUMENI

ANEKSI NR. 4

SHPENZIMET SIPAS NATYRËS EKONOMIKE PËR PERIUDHËN 2027–2029

Në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 të Bashkisë Tepelenë, miratohen tavanet e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike, si më poshtë:

(000/lekë)

Nr.	Emërtimi i shpenzimit	Llogaria ekonomike	2027	2028	2029
1	Paga	600	206,842	209,636	215,890
2	Sigurime shoqërore	601	33,472	33,920	34,950
3	Shpenzime operative	602	64,598	66,066	66,739
4	Transferta të brendshme	604	6,000	6,150	6,396
5	Transferta për individë	606	5,000	5,125	5,330
6	Fond rezervë	609	5,500	5,000	5,500
7	Fond kontigjencë	609	5,500	5,000	5,500
8	Shpenzime kapitale	230	1,810	0	16,015
9	Shpenzime kapitale	231	42,427	49,110	35,049
10	Mbrojtja civile	609	15,000	15,300	15,500
	Totali		386,149	395,306	406,869

Shpenzimet sipas natyrës ekonomike janë planifikuar në përputhje me tavanet e miratuara sipas programeve buxhetore dhe përfaqësojnë strukturën orientuese të përdorimit të fondeve publike për periudhën 2027–2029.

Shpenzimet kapitale (llogaritë ekonomike 230 dhe 231) përfshijnë investimet e planifikuara sipas prioriteteve të Bashkisë Tepelenë dhe do të detajohen në Aneksin Nr. 5, sipas projekteve konkrete dhe burimeve të financimit.

KRYETARI I KËSHILLIT

Arben GUMENI

ANEKSI NR. 5

TABELA E INVESTIMEVE KAPITALE

PËR PERIUDHËN AFATMESME 2027–2029

BASHKIA TEPELENË

Në zbatim të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029, paraqitet lista e investimeve kapitale të planifikuara nga Bashkia Tepelenë, sipas burimeve të financimit, projekteve prioritare, detyrimeve të mbartura dhe investimeve të reja.

PËRMBLEDHJE E INVESTIMEVE KAPITALE 2027–2029

Burimi i financimit	2027	2028	2029
Investime nga transferta e pakushtëzuar	21,430	35,000	23,428
Investime nga të ardhurat e Bashkisë	22,807	14,110	27,636
Totali	44,237	49,110	51,064

Investimet kapitale të paraqitura në këtë aneks do të zbatohen sipas burimeve të financimit të përcaktuara, procedurave ligjore në fuqi dhe mundësive financiare të Bashkisë Tepelenë.

Te analizuar ne tabelen bashelidhur ketij aneksi .

KRYETARI I KËSHILLIT

Arben GUMENI

TABELË SHOQËRUESE E ANEKSIT NR. 5
TABELA E INVESTIMEVE PER PERIUDHEN AFATMESME 2027-2029
INVESTIMET NGA TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR

(vula e Institucionit te Prefektit)

Nr	Emri I progamit/objektit					Vlera e kontrates	Likujdim progsiv deri me 2026	Mbetet per likujdim	Investime te reja Vlera e perafert	2027	2028	2029
	Gr	Kap	Prog.	Art	N/llog							
1	00	01	01110	231	2313100	3,000	3,000	0	0	0	0	0
2	00	01	01110	231	2313100	3,708	3,708	0	0	0	0	0
3	00	01	09120	231	2312103	18,645	11,715	6,930	0	6,532	6,532	0
4	00	01	09120	231	2312103		0	0	22,992	6,972	11,658	4,362
5	00	01	01110	231	2312118	24,950	4,193	0	24,950	2,305	7,310	15,335
6	00	01	04260	231	2313400				18,852	5,621	9,500	3,731
INVESTIME GJITHSEJT						50,303	22,616	6,930	66,794	21,430	35,000	23,428
SHUMA I												

INVESTIME NGA TE ARDHURAT												
Nr	Emri I progamit/objektit					Vlera e kontrates	Likujdim progsiv deri me 2026	Mbetet per likujdim	Investime te reja Vlera e perafert	2027	2028	2029
	Gr	Kap	Prog.	Art	N/llog							
1	00	05	04520	231	2313100	9,262	6,000	3,262	0	3,262	0	0
2	00	05	01110	231	2313100	12,390	3,200	9,190	0	3,000	6,190	0
3	00	05	01110	231	2312101	8,281	4,942	3,339	0	3,339	0	0
4	00	05	04260	231	2313400	5,040	3,000	2,040	0	2,040	0	0
5	00	05	09120	230	2302000	2,139	2,139	0	0	0	0	0
6	00	05	04260	230	2302000	5,310	3,500	1,810	0	1,810	0	0
7	00	05	01110	230	2302000	4,500	4,500	0	13,015	0	0	0
8	00	05	05100	231	2315140	4,000	4,000	0	7,200	1,200	3,000	13,015
9	00	05	01110	231	2313100	4,856	1,500	3,356		3,356	0	3,000
10	00	05	04260	231	2313400	0	0	0	18,341	4,800	4,920	0
11	00	05	04260	230	2302000	0	0	0	3,000	0	0	8,621
12	00	05	06260	231	2315140	0	0	0	0	0	0	3,000
INVESTIME GJITHSEJT						55,778	32,781	22,997	41,556	22,807	14,110	27,636
SHUMA II												
BUXHETI TOTAL (I+II)						106,081	55,397	29,927	108,350	44,237	49,110	51,064
						Kryetari Keshillit						
						Arben Gumeni						
						44237	0	0	0	0	0	0
						49110	51064					

ANEKS NR. 5/1
BASHKËFINANCIMET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHËN AFATMESME 2027-2029

Nr							Emri I programit/objektit			
	Gr	Kap	Prog.	Art	N/Ilog	Kodi projektit	2027	2028	2029	
1	00	01	09120	231	2312103	1420153	Bashkefinacim, Rikons Shkolla 7 Marsi 15 %	6,972	11,658	4,362
2	00	01	01110	231	2312118	1420147	Permiersim I banesave ekzistuese	2,305	7,310	15,335
3	00	01	04260	231	2313400	1420148	Rehabilitim I diges ujembledhesi Turan	5,621	9,500	3,731
4	00	02	08220	602	6022099	G142005	ARIADNE- Programi INTERREG VIA IPA GREECE- ALBANIA	2,040	0	0

KRYETARI I KËSHILLIT
Arben GUMENI